



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 332/01  
Datë: 29.06.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 26.05.2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. **Ri-akreditohet Qendra Sociale Edukative “Don Bosko”** me adresë Rr. Tahir Zajmi p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë për periudhën 07.02.2017 deri 07.02.2020 dhe ri-validohen këto kualifikime:
  - 1.1 Instalues Elektrik, niveli III sipas KKK, me 30 kredi të AAP;
  - 1.2 Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli III sipas KKK, me 27 kredi të AAP;
  - 1.3 Instalues i ngrohjes qendrore, niveli III sipas KKK, me 27 kredi të AAP.
2. Ri-akreditimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Instalues Elektrik:
  - 2.1 Për të krijuar një vazhdimësi të proceseve, pavarësisht ndërrimit të zyrtarëve përgjegjës rekomandohet menaxhmenti i qendrës që komunikimin zyrtar ta realizojë përmes adresave zyrtare.
  - 2.2 Më qëllim që të dihet se apo përmbushet synimi i punësimit apo avancimit të kandidatëve, rekomandohet që të funksionojë komunikimi për marrjen e informatave kthyesë dhe të vazhdohet kontakti me kandidatin.

- 2.3 Edhe përkundër faktit se menaxhmenti ka deklaruar se deri më tani nuk kanë pasur kërkesa për njohjen e kredive nga institucione të tjera, rekomandohet zhvillimi i procedurës për njohjen e kredive/moduleve.
  - 2.4 Për të gjithë dokumentacionin zyrtar i cili mund të përmbajë të dhëna të ndjeshme për qendrën apo kandidatët duhet të ketë procedurë të shkruar se kur dhe si mund të dalë jashtë qendrës.
  - 2.5 Të zhvillohet procedurë e shkruar e cila parasheh kriteret dhe mundësinë e ritestimit për kandidatët të cilët nuk e kalojnë testin final
  - 2.6 Që nga akreditimi i fundit, trajneri dhe ndihmës trajneri kanë ndjekur disa seminare të organizuara nga shkolla në bashkëpunim edhe me trajnerë të ardhur nga jashtë Kosove, por rekomandohet që ata të ndjekin apo marrin pjesë edhe në punëtori, seminare apo organizime të ngjashme që kanë të bëjnë me të rejtat e profilit.
  - 2.7 Të zhvillohet procedurë e shkruar e cila parasheh mënyrat e veprimit në rast të ndonjë incidenti në ambientet e shkollës.
  - 2.8 Rekomandohet menaxhmenti i qendrës të hartojë një plan veprimi të qartë për realizimin e të gjitha rekomandimeve të cekura më lart, përfshirë objektivat, aktivitetet, personelin e dedikuar dhe afatet kohore për realizimin e tyre.
3. Ri-akreditimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit:
    - 3.1 Hartimi i politikave dhe procedurave për të gjitha proceset e punës në Qendrën Sociale Edukative “Don Bosko”.
    - 3.2 Përgatitja e planit/ vjetor për implementimin dhe monitorimin e vlerësimit të kualifikimit.
    - 3.3 Përgatitja e planit për vlerësimin dhe verifikimin e brendshëm.
    - 3.4 Zhvillimi i formës së vlerësimit përmbledhës, sipas moduleve dhe llojit të vlerësimit.
    - 3.5 Zhvillimi i formularëve për identifikimin e nevojave për trajnim.
    - 3.6 Ridizajnimi i formularëve për vlerësim të performancës së stafit.
    - 3.7 Rishikimi i testeve për vlerësimin e pjesës teorike.
    - 3.8 Hartimi i testeve për vlerësim praktik.
    - 3.9 Hartimi i rregullores për siguri dhe shëndet në punë.
    - 3.10 Zhvillimi i formularëve për raportim të incidenteve.
  4. Ri-akreditimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Instalues i ngrohjes qëndrore:

- 4.1 Hartimi i politikave dhe procedurave për të gjitha proceset e punës në Qendrën Sociale Edukative “Don Bosko”.
  - 4.2 Përgatitja e planit/ vjetor për implementimin dhe monitorimin e vlerësimit të kualifikimit.
  - 4.3 Përgatitja e planit për vlerësimin dhe verifikimin e brendshëm.
  - 4.4 Zhvillimi i formës së vlerësimit përmbledhës, sipas moduleve dhe llojit të vlerësimit.
  - 4.5 Zhvillimi i formularëve për identifikimin e nevojave për trajnim.
  - 4.6 Ridizajnimi i formularëve për vlerësim të performances së stafit.
  - 4.7 Rishikimi i testeve për vlerësimin e pjesës teorike.
  - 4.8 Hartimi i testeve për vlerësim praktik.
  - 4.9 Hartimi i rregullores për siguri dhe shëndet në punë.
  - 4.10 Zhvillimi i formularëve për raportim të incidenteve.
5. Kushtet e parashtruara për ri akreditim duhet të përmbushen deri më datën 01.09.2017, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

### **A r s y e t i m**

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

#### Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
7. Vendimi u dërgohet:
  - Don Bosko;
  - AKK.

  
Kryetari i KD së AKK-së  
Bedri Xhafa

